

**“Kanuni i Zhuriës”,
një akt i rëndësishëm për organizimin e funksionimin
e sistemin gjyqësor shqiptar**

Nga Dr. Xhavit Shala
Drejtor i Kërkimeve Shkencore
Akademia e Sigurisë

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, qeveria e dalë nga Kuvendi i Vlorës, ndonëse në kushte të vështira dhe në një territor të ngushtë, filloi ngritjen e strukturave bazë të shtetit të ri shqiptar. U investua ndërmjet të tjerave në tre drejtime kryesore dhe konkretisht në ngritjen e sistemit gjyqësor, organizimin strukturor të qeverisjes vendore si dhe ngritjen e strukturave të reja të sigurisë.

Kështu, më 23 maj 1913, qeveria e dalë nga Kuvendi i Vlorës, miratoi “Kanunin e Zhuriës”, i përgatitur që më 13 maj nga ministri i Drejtësisë, Petro Poga. Hartimi dhe miratimi i këtij dokumenti përbënte një hap të rëndësishëm për krijimin e drejtësisë penale të shtetit të ri shqiptar¹. “Kanuni i Zhuriës” kishte si qëllim mbrojtjen e rendit e të sigurisë dhe luftën kundër fajeve (veprave penale) nëpërmjet hetimit e gjykimit të tyre sipas ligjit. Në një farë mënyre ky akt juridik hodhi themelet e një procedure penale shqiptare. Në të jepej nocioni i fajit (veprave penale) dhe ndarjes së tij në tri kategori sipas modelit perëndimor: në faje të dëmeve, faje të vështira (*delikte*) dhe faje të *shëmtueme* (krime). Sipas këtij akti juridik “Çdo punë që rrëzon të drejtat e robit duke prurë dëm e ndalim në jetën, në lirin, dhe në kamjen e tij është faj. Fajet janë të ndalueme nga qeveria, e cila është e detyruar të ruajë jetën, lirinë dhe kamjen e çdo njeriut. Cilido fajtor dënohet pas kanunit të dënimit. Fajet janë tri lloj: fajet e dëmevet, fajet e vështira dhe fajet e shëmtimevet². Në këtë dokument përcaktohen dhe shkallët e gjyqësorit që do t’i gjykojnë fajet sipas kategorizimit të tyre. “Dëmet dhe të vështirat do të gjykohen në gjykata të veçanta. Shëmtimet do të gjykohen pas zakoneve të Shqipëriës me anë të pleqësiës që do jet e betuar e që prandej quhet zhurië. Për zgjedhjet dhe mënyrën e gjykimit të së cilës u fillua një kanun i tillë”³.

Përveç sistemit të drejtësisë penale, Kanuni i Zhuriës përbën një akt të rëndësishëm edhe për organizimin dhe funksionimin e sistemin gjyqësor shqiptar. Në pjesën e parë të kanunit përcaktohen rregullat për zgjedhjen, organizimin dhe funksionimin e zhuriës, pra për organizimin e drejtësisë e penale në të cilën gjykohet me juri. Pas një sistemi zgjedhjesh për anëtar të jurisë të përshkruar deri në detaje⁴, përcaktohen dhe kriteret për të qenë anëtar jurie.

¹Kanun i Zhuriës, botuar në Revistën “Përlindja e Shqipëniës” në disa numra resht dhe konkretisht: në numrin 13, e mërkurë 12/25 shkurt 1914, f. 4-5; në numrin 14, e shtunë 15/28 shkurt 1914, f. 4-5; në numrin 15, e mërkurë 19/4 mars 1914, f. 4-5; në numrin 17, e mërkurë 26/11 mars 1914, f. 4-5; në numrin 18, e shtunë 1/14 mars 1914, f. 4-5;

²Kanun i Zhuriës, botuar në revistën “Përlindja e Shqipëniës” 12/25 shkurt 1914, Parathënie, f. 4, Vlorë 1914.

³Po aty.

⁴Po aty. Neni 1 deri 8.

“Ata që do zgjidhen në pleqësinë e zhurisë duhet të jenë njerëz të ndershëm me këto shenja 1. nën urdhër shqipëtar, 2. të kenë mbushur 20 vjet, 3. të paguaj në qeverie pak e shumë pagesë, 4. shkollarë, avukatë, shëronjës, barnabënjës, tregtarë të pa varfëruar, 5. Cili do që do të ketë mbaruar një shkollë të mesme. Nga këta do preferohen të mirët, të diturit, të provuarit”⁵. Në pjesën e dytë të “Kanunit të Zhurisë” jepen hollësitë dhe rregullat e përgatitjes së procesit të gjyqimit, duke filluar nga seanca përgatitore, zgjedhja nga lista e miratuar e anëtarëve të jurisë, pranimit dhe caktimit i mbrojtjes, si dhe bëja (betimi) i anëtarëve të jurisë⁶ duke përcaktuar dhe formulën përkatëse dhe deri në mënyrën e rreshtimit të palëve në sallën e gjyqit⁷. Si të mbarojë bëja “kryetari i gjykatës do të rrijë në krye, në të djathtë të tij do të rinë anëtarët e gjykatës dhe në fund prokurori, dhe nga anë e mëngjër do rrijë kryetari i zhurisë”⁸.

Në pjesën e tretë përshkruhet mënyra e zhvillimit të gjyqit, duke filluar nga pyetja e nënëgjyqësit (të pandehurit) për gjeneralitetet, pyetjen e dëshmorëve (dëshmitarëve), fjalën e prokurorit, mënyrën e marrjes dhe të komunikimit të vendimit etj.⁹.

Letërfitim.

Më 8 të korrik 1913 në katundin zherijes të Elbasanit është vramë Musaj prej katundit zherijes të Elbasanit. Për këtë ngjarje i pandehur kuptohet Veliu edhe Osmani prej katundit zherijes të.

Me anën e këtij letërftimi Gjykata e Shëmtimevet të Elbasanit fton këtë të pandehur të vijë përpara 'sad në dhetë dit e sipër, se, si të shkojnë dhetë dite të mos çfaqet, gjyqi do të përgatitet edhe do të shifet paçfaqësisht.

Ky letërfitim mbas nryt 21 të kanunit të Zhurisë po botohet edhe në gasetë.

Elbasan. 26 Vjeshtë e III 1913.

Në pjesën e katërt të titulluar “Gjyqi pa çfaqje” përshkruhen rregullat për zhvillimin e gjyqit në mungesë të fajtorit, etj. Edhe kur nuk arrestohet shëmtuesi (autori i krimit) pyetësi (hetuesi) do të hetojë ngjarjen, mbledhë provat, “raportin e mjekësisë dhe të autopsisë”, pyesë dëshmorët

(dëshmitarët), etj. Pasi të mbarojë hetimet “shkruan vendimin e ankimit dhe si ta nënshkruajë mbledh letrat e ngjarjes dhe të gjitha ja jep prokurorit dhe prokurori i dërgon në gjykatë”¹⁰ dhe urdhëron xhandarmërinë që “ta zere të ikurin apo të ikurit (filar)”¹¹. Pas kësaj gjykata i jep dhjetë ditë kohë firarit që të paraqitet në gjykatë. Këtë njoftim gjykata ja dërgon në vendin ku ai rri ose në gazeta. Pasi kalojnë dhjetë ditë dhe autori nuk paraqitet, fillojnë procedurat për zhvillimin e

⁵Po aty, Neni 3, f. 4.

⁶Kanun i Zhurisë, neni 12: Beja (betimi) i anëtarëve të jurisë do të bëhet ditën e gjyqit, përpara fillimit të seancës, përpara kryetarit të Gjykatës dhe Prokurorit, duke e vënë dorën në libër të shenjtë, secili sipas fesë së tij sipas kësaj formule: “Beto hem në emër të Perëndisë që është një dhe jap besën e shqiptarit që në gjyq që do të gjykoj, do të zgjedh të vërtetën pa frikë nga njeri por vetëm me frikën e Zotit pa mbajtur anë e askujt. Nuk do të vë re as armiqësi, as fjale e as lutje do të ndëgjoj nga njëri për vetëm diktoj të vërtetën në mendje e në shpirt të liruar, dhe se do ta them dhe do ta jap votëm time vetëm për të vërtetën dhe në punofsha kundër zërit tim Zoti më gjykoftë”. Pas kësaj Kryetari i Gjyqit do të përgjigjet “Në mos gjykoftë më të drejtë, Zoti të gjykoftë”.

⁷Po aty, Neni 9 deri 12.

⁸Po aty, Neni 12.

⁹Kanun i Zhurisë, botuar në Revistën “Përlindja e Shqipëniës”, në numrin 15, E Mërkurë 19/4 Mars 1914, Neni 13 - 16, f. 4-5.

¹⁰Kanun i Zhurisë, botuar në Revistën “Përlindja e Shqipëniës”, në numrin 17, E Mërkurë 26/11 Mars 1914, f. 4-5, Neni 20.

¹¹Po aty.

gjqyt “paçfaqësisht” (në mungesë) dhe pa përfaqësuesin e tij, deri në daljen e vendimit të gjykatës. “Niset gjyqi dhe gjikonet pa përfaqësonjës nga ana e paçfaqurit dhe mbaronet sikur do ish faqeza”¹². Pas daljes së vendimit, gjykata i jep përsëri kohë edhe 21 ditë të tjera për të kundërshtuar këtë vendim. “Cilido që të jetë dënuar me letërvendim pa çfaqje, që nga dita që ti’i ipet letërvendimi në dorë a në shtëpi a në fëmijë të tija, në njëzet e një dit’ e ka të drejtë ta kundërshtojë me kërkesë që do të jepet tek Kryetari i Gjykatës për tu vështruar gjyqi përsëri”¹³, këtë herë duke qenë i arrestuar. Në të kundërtën nuk pranohet kërkesa dhe pas kalimit të afatit 21 ditor vendimi merrte formë të prerë dhe ishte i përmbarueshëm. Pas kësaj parashikoheshin procedura të veçanta për “firarin”. Kështu, “nëqoftëse s’vjen t’i bëjë kundërshtim vendimit po mbetet i pa çfaqur dhe t’mos ipet, kudo që të gjendet, të vritet prej zhandarmërisë, dhe do ti merret kamja e tija, c’do gjë të ketë nga ana e qeverisë dhe do ti shitet në ankan për qeverien, dhe fëmij’ e tija do t’i ngrihen e do ti dërgohen në tjetër vend të Shqipërisë”¹⁴. Kjo procedurë ishte parashikuar të ndiqej për të gjitha fajet e kategorisë “shëmtime” (krime), në të cilën përfshihen dhe vrasjet në familje. Pra, procedura për autorët e pa dorëzuar të vrasjeve, pas kalimit të afatit 21 ditor të ankimit, parashikonte edhe vrasjen e tyre nga xhandarmëria, konfiskimi i kamjes (pasurisë) dhe internimin e familjes. Vetëm nëse vendimi i gjykatës është me vdekje, ai është automatikisht i apeluëshëm dhe do të përmbarohet “pasi të vërtetohet nga gjykata e diktimit”¹⁵.

Në pjesën e pestë të “Kanunit të Zhuriës”, të quajtur “Diktimi”, jepen procedurat dhe afatet e apelimit (diktimit) të një vendimi¹⁶, ndërsa në pjesën e gjashtë dhe të fundit të “Kanunit të Zhuriës”, të titulluar “Përmbarimi”, jepen afatet e përmbarimit të vendimeve të gjykatave. Përveç vendimeve të dënimit me vdekje, të cilat përmbarohen pasi të jenë shqyrtuar nga Gjykata e Diktimit, vendimet e tjerë hyjnë në fuqi pas një afati dhjetë ditë nëse nuk kundërshtohen¹⁷. Në zbatim të “Kanunit të Zhuriës” u ngritën gjykatat e para shqiptare. Në Vlorë u krijua e para gjykatore politike dhe penale, me kryetar Kristo Floqin, e cila, më pas, u quajt Gjykata Kriminale e Vlorës. Gjykata u krijuan dhe në Berat¹⁸, Lushnjë¹⁹ e Elbasan²⁰.

Pas një analize në këndvështrimin historik dhe juridik të “Kanunit të Zhuriës” mund të arrijmë në përfundimin se ai përbën një akt të rëndësishëm për organizimin e funksionimin e sistemin

¹²Po aty, Neni 21.

¹³Kanun i Zhuriës, botuar në Revistën “Përlindja e Shqipëniës”, në numrin 18, E Shtunë 1/14 Mars 1914, f. 4-5, Neni 22.

¹⁴ Kanun i Zhuriës, botuar në Revistën “Përlindja e Shqipëniës”, në numrin 17, E Mërkurë 26/11 Mars 1914, f. 4-5, Neni 21.

¹⁵Kanun i Zhuriës, botuar në Revistën “Përlindja e Shqipëniës”, në numrin 18, E Shtunë 1/14 Mars 1914, f. 4-5, Neni 22.

¹⁶Po aty, Neni 23 deri 26.

¹⁷Po aty, Neni 29

¹⁸Revista “Përlindja e Shqipëniës”, Nr.19, 2/15, Vjeshtë e Dytë, f. 6, Viti 1913.

¹⁹Revista “Përlindja e Shqipëniës”, Nr.23, E mërkurë, 30/12, Vjeshtë e Dytë, f. 8, Viti 1913: Njoftim i Kryetarit të Gjykatës Politike Lushnje, datë 23.10.1913.

²⁰Revista “Përlindja e Shqipëniës”, Nr.32, E Shtunë, 7/20, Dhjetor. Viti 1913, f. 6: Njoftim i Gjykatës së Shëmtimeve të Elbasanit, 26, Vjeshtë e Tretë, 1913.

gjqësor dhe atij procedural penal shqiptar. Procedurat që ai përcaktoi për hetimin, gjykimin dhe përmbarimin e vendimeve në rastet e krimeve të rënda (shëmtimeve), shërbyen si model edhe në qeverisjet e mëvonshme shqiptare deri ne vitin 1938, duke ndikuar në vendosjen dhe ruajtjen e rendit e të sigurisë dhe luftën kundër krimit e vrasjeve në Shqipëri.

Në vijim, për t'ia lënë komentet e tjera vetë lexuesit të revistës sonë, po e botojmë të plotë “Kanunin e Zhurisë”.